



BASHKIA  
TIRANË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA TIRANË

DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR MARRËDHËNIET ME PUBLIKUN

Nr. A-9928/1 prot.

Tiranë, më 18/05/2021

Lënda: **Kthim përgjigje**

**ALBANIAN INSTITUTE OF SCIENCE**  
Rruga: "Asim Vokshi", godina 13/25, kati 3, Tiranë

E nderuar znj. Brahaj,

Pranë Bashkisë së Tiranës, bazuar në ligjin 119/2014 "Për të drejtën e Informimit" është paraqitur kërkesa juaj, e cila është protokolluar me nr. prot. A-9928, datë 07.05.2021 dhe ka kaluar për shqyrtim në Këshillin Bashkiak, ku ka kthyer përgjigje me shkresën me nr. prot. A-9928/1, datë 18.05.2021 si më poshtë:

"Në vijim të kërkesës suaj nëpërmjet së cilës është kërkuar informacion dhe akses në listat me përfitues nga fondet e rindërtimit, ju informojmë se listat e përfituesve, të cituara si anekset bashkëlidhur në këto vendime, përmbajnë të dhëna personale të përfituesve, si numër identifikimi, të dhëna mbi përfitimin ekonomik etj, të cilat mbrohen nga ligji nr. 9887, datë 10.3.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" (i ndryshuar), citoj nenin 3 pika 1, të ligjit:

Në këtë ligj, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

"Të dhëna personale" është çdo informacion në lidhje me një person fizik, të identifikuar ose të identifikueshëm, direkt ose indirekt, në veçanti duke iu referuar një numri identifikimi ose një a më shumë faktorëve të veçantë për identitetin e tij fizik, fiziologjik, mendor, ekonomik, kulturor apo social.

Thënë këtë, në pamundësi për t'iu vënë në dispozicion listat e kërkuara, më poshtë ju njohim me nr. e përfituesve për çdo vendim objekt i kërkesës suaj:

- VKB nr. 66, datë 19.04.2021 "Për miratimin e listës së përfituesve nga Programi i Grantit të Rindërtimit", 40 përfitues të kategorisë DS5.
- VKB nr. 65, datë 19.04.2021 "Për miratimin e listës së përfituesve të nënprogramit të grantit të rikonstruksionit, banesat e të cilëve janë klasifikuar nga akt ekspertizat e thelluara të Institutit të Ndërtimit me nivel dëmi DS4" 7 përfitues të kategorisë DS4.

- VKB nr. 64, datë 19.04.2021 “Për miratimin e listës së përfituesve nga Granti i Rikonstruksionit dhe për disa ndryshime në Vendimet e Listave të Përfituesve nga ky nënprogram”, 150 përfitues (nga të cilët 36-përfitues DS1 , 49 - përfitues DS2 dhe 65 - përfitues DS3).
- VKB nr. 63, datë 19.04.2021 “Për miratimin e listës së përfituesve nga Programi i Zhvillimit të Objekteve të Reja në Njësinë Administrative nr. 6, Baldushk, Ndroq dhe Pezë”, 195 përfitues (nga të cilët Baldushk - 13 përfitues DS5, Kombinat - 100 përfitues DS5, Ndroq - 31 përfitues DS5, Pezë - 22 përfitues DS5, Njësia nr. 6 ish hoteli i beqarëve 29 - përfitues DS3).
- VKB nr. 61, datë 06.04.2021 “Për disa korrigjime gabimi material në Vendimet e Listave të Përfituesve nga Granti i Rikonstruksionit dhe Programi i Rindërtimit”. Në këtë vendim është bërë korrigjim material për 164 përfitues të disa VKB-ve (korrigjim në emrat e përfituesve, kategoritë e dëmeve ose nr ID).
- VKB nr. 16, datë 01.03.2021 “Për miratimin e listës së përfituesve nga Granti i Rikonstruksionit”, 107 përfitues (nga të cilët 36 - përfitues DS1, 35 - përfitues DS2 dhe 36 - përfitues DS3).
- VKB nr. 17, datë 01.03.2021 “Për miratimin e listës së përfituesve nga Programi i Zhvillimit të Objekteve të reja në Njësinë Administrative nr. 6”, 140 përfitues të kategorisë DS5.
- VKB nr. 7, datë 13.02.2021 “ Për miratimin e listës së përfituesve të nënprogramit të Grantit të Rikonstruksionit, banesat e të cilëve janë klasifikuar nga aktepertizat e thelluara nga Instituti i Ndërtimit me nivel dëmi DS4”, 33 përfitues të kategorisë DS4.
- VKB nr. 8, datë 13.02.2021 “Për miratimin e listës së përfituesve nga Programet e Procesit të Rindërtimit”, 178 përfitues të kategorisë DS5.
- VKB nr. 6, datë 13.02.2021 “Për miratimin e listës së përfituesve nga Granti i Rikonstruksionit”, 540 përfitues të kategorive DSI, DS2, DS3 (nga të cilët 154 - përfitues DS1, 178 - përfitues DS2 dhe 208 - përfitues DS3”).

Sa më sipër lutemi në dijeninë tuaj.

Me respekt,

**KOORDINATORI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT**

  
Blerta Goxha